

# DËSHTIM NË 100 HAPA

apo

## si sunduan “rilindësit” katër vite pas ardhjes së Gruevskit në koltukun e premierit

1. E degraduan ekipin i cili e siguroi kandidaturën për BE;
2. Nuk siguron datë për fillimin e bisedimeve me BE-n;
3. E shndërruan qeverinë në “Muze të antikës”;
4. E riemërtuan aeroportin na i përzunë miqtë;
5. E riemërtuan autostradën, hupëm 77 milion euro ndihmë të pakthyeshme;
6. E minuan principin e Badinterit dhe e bllokuan Komitetin për marrëdhënie mes bashkësive;
7. “Luftëtari për emrin kushtetues” u mburrë që u pranua në Partinë Popullore Evropiane si “premier i IRJM-s”;
8. Edhe pos premtimeve, nuk arritën të na fusin në NATO;
9. Me vendimin për zgjedhje të parakohshme i rrezikuan euro-integritet;
10. Zbatuan zgjedhje më katastrofave në historinë tonë;
11. Premieri lavdërohej si “luftëtar”, por nuk kishte guxim për TV ballafaqim;
12. Me vendimin për ndërtimin e kishës shtetërore shkaktoi përçarje, dhunë dhe jo-tolerancë;
13. Harxhuan dhjetëra milionë euro në fushata komerciale pa kuptim me qëllim të korrupsionit të mediumeve;
14. E keqpërdorën kanalin e kuvendit për vetë-reklamim;
15. Zbatuan ndalime të pakuptimta, siç ishte ajo për blerjen e alkoolit pas orës 19.00;
20. Zbatuan politikë gjobuese drakonike duke na zbratur xhepat;
21. Kuvendin e shndërruan në makinë votuese dhe turp për demokracinë;
22. E minuan miratimin e strategjisë shtetërore për kontestin me emrin;
23. E nënçmuan institucionin Kryetar, kurse kur zgjodhën “aneks kryetar” e marginalizuan në tërësi;
24. Miratuan ligje dhe vendime të cilët Gjyqi Kushtetues i rrëzonte si dardha të kalbura;
25. Pa turp e sulmonin Gjyqin Kushtetues dhe nuk i zbatonin vendimet e tij;
26. Nuk e respektonin ligjin për qasje të lirë të informatave të karakterit publik;
27. Pas tre viteve të tëra lajmëruan për projektin tetëvjeçar “Shkupi 2014”;
28. Administratën publike e mbushën me punësime partiake, të posapranuarit marrin rrogë duke mos shkuar në punë;
29. “Realizojnë 24/7”, kurse premieri tradicionalisht vonohej më së paku gjysmë ore;
30. Në vend që të lobon në vendet anëtare të BE-s dhe në SHBA, ministri i punëve të jashtme “lobonte” nëpër fshatrat maqedonase;
31. Ambasadat më të rëndësishme i lanë të zbrazëta kur ishin më të nevojshme;
32. Për ambasadorë emëruan shërbyes partiak të cilët nuk kanë kapacitet të menaxhojnë as këshill shtëpiak. Emëruan ambasador anti-nato në NATO;
34. Në Hagë ngritën kontest për mbrojtjen e referencës së përkohshme;
33. Promotorët e paguar shtrenjtë ekonomik nuk arritën asgjë;
34. Premtuan “kryesim maqedonas” në Këshillin e Evropës, kurse Miloshoski kryesoi në emër të IRJM-s;
35. I plaçkitën qytetarët për pasaporta me “procedurë të shpejtë” njëmuore;
36. Endryshuan ligjin që të mundet “kushëriri i madh” pa kontroll ti ndjekë gjitha llojet e komunikimeve në çdo kohë;
37. Bënë ndërhyrje policore në Kuvend;
38. Vendosën kamera të shumta në vende publike. Kamerat e kuvendit tani më i keqpërdorën;
39. Burgosjet spektakolare policore nuk kishin mbarim gjyqësor adekuat;
40. E dhunuan të drejtën për protestim të qetë të studentëve më 28.03.2009 dhe të rrahurit i barazuan me ata që rrahën;
41. E rrezikuan sigurinë e të falimentuarve duke shkaktuar kaos në trafik;
42. Kryen okupim policor të tregut në “Shuto Orizare”, dhe konfiskuan mall i cili mundet të blihet në çdo qendër tregtare;
43. E keqpërdorën MPB-n, burgosën dhe ndoqën pa të drejtë ata që kritikuan pushtetin;
44. Kryen shtypje dhe frikësim të paparë mbi gjyqësinë;
45. Miratuan ligj kundër-kushtetues për lustrim me të cilin e amnistuan prokurorin shumëvjeçar komunist – ministrin e tanishëm të drejtësisë;
46. E bllokuan iniciativën qytetare për referendum për ndërtimin e objekteve fetare në sheshin e Shkupit;
46. Kontribuuan që të shpallemi për kampionë botërorë në papunësi;
47. Disa herë në mënyrë “ligjore” ua shkurtuan të drejtat punëtorëve;
48. Iniciuan “mobing” partiak dhe diskriminim partiak;
49. Sollën ligj anti-evropian për anti-diskriminim pasi realizuan fushatë diskriminuese;
50. Diskriminuan edhe me politikën për stimulimin e rritjes së popullatës;
51. Nuk i respektuan kuotat për gratë që nga zgjedhja e anëtarëve të KQZ-s;
52. Listën zgjedhore të pa pastruar nuk e dorëzuan në KQZ;
53. Mblodhën edhe një haraç me llogaritë fiskale “patriotike” kundër-kushtetuese;
54. Nuk lejuan debat parlamentar për raportet revizore të cilët treguan harxhim joligjor dhe keqpërdorime financiare;
55. Morën kredi afatshkurta nga bankat me norma të larta të interesit;
56. Nuk i paguan në rregull borxhet ndaj ndërmarrjeve dhe nuk e kthyen në kohë TVSH-n;
57. Harxhuan dhjetëra milionë euro për projektin “Komputer për çdo fëmijë”, në vend që ti rinovojnë shkollat;
58. “Librat pa pare” u vonuan apo u botuan me gabime trashanike dhe me përmbajtje joprofesionale dhe të dyshimta;
59. Me studimet e shpërndara e ulën kualitetin e arsimit;
60. Instaluan shërbyes partiak për liderë të studentëve dhe i harruan të drejtat e studentëve dhe standardin katastrofal studentor;
61. Zbatuan mësim fetar në arsim, e prishën karakterin laik të arsimit dhe i ndanë nxënësit në bazë fetare;
62. Me shtypje e rrezikuan të drejtën për grevë në arsim;
63. E përkrahën “Enciklopedinë Maqedonase” e cila shkaktoi prishje të marrëdhënieve ndëretnike dhe marrëdhënieve me fqinjët;
63. Botuan 500 libra të shtrenjtë të përkthyer në mënyrë joprofesionale;
64. I hoqën “vauçerët” për studentët për shkak të krizës, kurse nuk e ndërprejnë ndërtimin e 100 terreneve për tenis të cilët kushtojnë 8.5 milionë euro;
65. Lëshuan në përdorim salla të shtrenjta sportive shkollore të cilat nuk përdoren;
66. Harxhuan miliona euro për terrene futbollit pa kualitet;
67. Harxhuan miliona euro për “Investo në Maqedoni”, kurse investimet e huaja janë më të voglat në rajon;
67. Hapën zona të lira ekonomike të cilët rinë të zbrazëta;
67. Hodhën miliona euro në fushata për tërheqjen e turistëve të huaj, kurse këtë vit kishim vizitë më të dobët turistike;
68. Ndërtuan “Plazh Shkupi” pranë lumit plotë me baktere të rrezikshme;
68. Bën doli me “Swedmik”-un, a pasi që falimentoi i lanë fermerët pa ndihmë;
69. Bënë fushatë partiake nga mbjellja e miliona drurëve kurse pyjet na zhduken;
70. Harxhuan para të mëdha, kurse hidrocentralet “Çebren” dhe “Gradishtë” nuk ka kush ti ndërtojë;
71. E sollën para shkatërrimit “Zletovicën” e cila vlen 80 milionë euro;
72. Sollën ligj anti-evropian për ujërat, përsëri për shkak të interesave të dikujt;
73. Në vend që të ndërtojnë autostrada të reja, lejuan shkatërrim të rrjetit rrugor;
74. Premtorin ndërtimin e më shumë rrugëve por nuk i ndërtuan;
75. Treni modern nga fushata e VMRO-DPMNE-s asnjëherë nuk erdhi;
76. Nuk e mbaruan sistemin për gazifikim për shkak të importit të rrymës së shtrenjtë;
77. Krijuan kaos në trafikun ajror. Qytetarët udhëtojnë me bileta më të shtrenjta kurse përfitojnë shërbime pa kualitet;
78. U fundos “Illinden”-i së bashku me shumë turistë të huaj, kurse ministri përgjegjës nuk dha asnjë përgjegjësi;
79. Lejuan të derdhe Liqeni i Ohrit, kurse ministri përgjegjës na binde se ato qenkan “ujëra nëntokësor”;
80. Krijuan kaos dhe jo kualitet në radiodifuzion me hiper-prodhim të licencave dhe moszbatimin e ligjit;
81. E poshtëruan MRTV-n duke e shndërruar në servis partiak me shikueshmëri më të ulët në historinë e vet;
82. Vendosën të harxhojnë shtatë milionë euro për ashensor deri te kryqi në Vodno, kurse Shkupi ngeli pa tramvaj;
83. Rregulluan tenderë, kurse autobusët njëkatësh dhe dykatësh akoma nuk janë në kryeqytet;
84. Premtuan ndërtimin e “Qytetit të Diellit”, por dielli assesi ta ngrohë;
85. Sollën Ligj për amvisëri i cili nuk mundet të zbatohet dhe përsëri u kanosën me dënime të mëdha;
86. Me ulje drastike të buxhetit e sollën në pyetje gatishmërinë luftarake të ARM-s;
87. Bënë shtypje mbi ushtarët profesional të cilët luftonin për të drejtat e tyre të shkurtuara;
88. Realizuan fushatë të fshehtë kundër të drejtës për ndërprerjen e shtatzënisë duke i stigmatizuar gratë dhe mjekët;
89. Zbatuan fushata për “fëmijë të tretë”, kurse spitalet i shndërruan në institucione për ekzekutime;
90. I shtrenjtuan barnat dhe krijuan mungesë të barnave me recetë duke e rrezikuar jetën e të sëmurëve kronik;
91. Me kamerat nëpër spitale e cenuan intimitetin e pacientëve;
92. Vazhduan ta injorojnë varfërinë që është në rritje. Ndanë dhjetë herë më tepër mjete për përmendore se sa për luftën kundër varfërisë;
93. Cuan “luftë” hipokrite kundër korrupsionit dhe kriminalitetit. Kryen ndërhyrje në Komisionin për Anti-korrupsion dhe në Drejtorinë për larjen e parave;
94. E bllokuan decentralizimin. I privilegjuan komunat ku ndodhen prefektët e tyre;
95. E keqpërdorën dëshirën e votuesve të komunës Qendër dhe sollën vendime antiligjore për ndërtimin e shumë përmendoreve të shtrenjta;
96. Kryen hulumtime megalomane arkeologjike kurse i lanë të pambrojtur përmendoret e kulturës;
97. Porositën qindra figura (1.5 milionë euro) për muzeun e VMRO-s gjatë krizës më të madhe, papunësisë dhe varfërisë;
98. Problemet e qytetarëve i injoruan, kurse paratë e buxhetit u derdhën në shkretoret e huaja dhe në xhepat e disa artistëve dhe “mentorëve”;
99. Nëpërmjet propagandistëve të tyre të paguar shtrenjtë, përhapnin gënjeshtër, ofendime që të dekurajojnë kritikën ndaj “Rilindjes”;
100. Investitorët dhe zyrtarët e huaj i bindën që të na tejkalojnë. Siç na tejkalojë naftësjellësit, gazsjellësit dhe korridorët.

**Edhe sa “hapa rilindëse” deri në humnerë?**